



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 nëntor 2013
Nr. ref.: RK490/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI-70/13

Parashtrues

Asllan Bahtiri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në
Prishtinë, P. nr. 529/2008, të 1 dhjetorit 2010**

GYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Asllan Bahtiri nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 529/2008, i 1 dhjetorit 2010, i cili është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 77/2011, të 18 janarit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 529/2008, të 1 dhjetorit 2010, me të cilin parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes dhe me vendim të formës së prerë ishte dënuar me burgim prej dy vjet dhe tetë muaj (2 vjet e 8 muaj), ndërsa kopjen fizike të aktgjykimit parashtruesi i kërkesës kishte refuzuar ta pranojë.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 maj 2013, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Me Vendimin e Kryetarit (nr. GJR. 70/13, të 27 majit 2013), gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi u caktua si Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit, nr. KSH. 70/13, u caktua Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 25 korrik 2013, Gjykata Kushtetuese kërkoi dokumente shtesë nga Gjykata Themelore në Prishtinë.
8. Më 30 korrik 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë e njoftoi Gjykatën Kushtetuese se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 529/2008, i 1 dhjetorit 2010, kishte marrë formën e prerë më 18 janar 2012.
9. Më 17 tetor 2013, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu, shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese, Arta Rama-Hajrizi, dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 529/2008, të 1 dhjetorit 2010, parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes dhe është dënuar me burgim prej dy vjet e tetë muaj (2 vjet e tetë muaj).

11. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 529/2008, i 1 dhjetorit 2010, është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 77/2011, të 18 janarit 2012. Aktgjykimi kishte marrë formën e prerë më 18 dhjetor 2012, ndërsa parashtruesi i kërkesës kishte refuzuar ta pranojë kopjen fizike të aktgjykimit.

Pretendimet e parashtruesit

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“është shkelur e drejta për mbrojtje për veprën për të cilën akuzohet, thuhet se (vepra) është kryer në Gjermani, në vitin 1998, ndërsa gjykohet në Kosovë; kërkon që të kthehet në Gjermani dhe atje të mbahet gjykimi, ku janë edhe provat”*.
13. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese, si në vijim:

Kërkoj të ma ktheni këtë lëndë në rigjykim edhe seancat të jepen në TV si disa persona që po i shfaqni në TV, por që të incizohet, se mua më ka humbur besimi në drejtësi, e kështu askush s'mund të manipulojë me askënd. Gjykata çdo vendim e merr “Në emër të popullit”, dhe sipas kësaj, asgjë nuk duhet të fshihet nga populli.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligj.
15. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese i referohet nenit 49 (Afatet) të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të llogaritet që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

16. Në bazë të dokumentacionit shtesë dorëzuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 529/2008, i 1 dhjetorit 2010, ka marrë formën e prerë më 18 janar 2012, ndërsa parashtruesi i kërkesës ia dorëzoi parashtrësën më 14 maj 2013, Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese.
17. Nga kjo rrjedh se kërkesa nuk është e pranueshme për shqyrtim në pajtim me nenin 49 (Afatet) të Ligjit dhe rregullin 36 (1b) të Rregullores së punës, i cili përcakton: *„Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi“*.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, si dhe në pajtim me rregullin 36 (1b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 17 shtator 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani